



Buletini nr. 149-Prill- 2016- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 149 – Prill – 2016 – Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



NDËRTIMI DHE HAPJA E ÇERDHES SË PARË PUBLIKE NË MALISHEVË



Përmbajtja:

Marsi, mbyllet edhe me një sukses të nxënësve malishevas.....	3
Administrata komunale shënoi Ditën e Pastërtisë	3
Faza e parë e repelimit të kafshëve, përfundon këtë javë	4
Begaj dhe Morina, panë nga afër realizimin e disa projekteve	4
Kuvendi i Komunës së Malishevës, miratoi raportin financiar për vitin 2015	5
Projekti i Pajtim Bytyqit, më i miri në “International Conference GREDIT 2016”	6
Mërgimtari Bashkim Shala, i dhuroi kabinet të informatikës, shkollës në Guncat.....	7
Kryetari Begaj: Dyert e hapura për qytetarë.....	8
Malisheva, vazhdon të jetë komuna më e sigurt në vend	8
Kërvasaria mblodhi intelektualët e saj, për ti kujtuar dëshmorët	9
Nxënësit malishevas, mbajnë orë praktike në fushën e Astronomisë.....	10
Filloi asfaltimi i rrugëve në Guncat	11
Delegacioni i Malishevës, vazhdon vizitën në Slloveni	12
Delegacioni i Malishevës, vazhdon vizitën në Slloveni	12
U hap çerdhja e parë publike në Malishevë	13
Aktualisht po realizohen projekte në shtatëdhjetë për qind të fshatrave	14
Asfaltohet edhe një rrugë në Pagarushë	15
Kryetari Begaj, priti përfaqësuesin e klubit të shqiptarëve në Sundern të Gjermanisë, Fadil Bytyçin ...	16
Deri në fund të vitit, parashihet të përfundoj projekti i ujësjellësit për 14 fshatra të Malishevës	17
Filloi dezinfektimi selektiv kundër rriqrave	18
U mbajt krosi pranveror në Malishevë, ku morën pjesë 350 garues.....	19
Komiteti për Politikë Financa, mbajti mbledhjen e rregullt.....	21
Vazhdojnë aktivitetet për parandalimin e EHKK.....	22
Përfundoi dezinfektimi kundër rriqrave në Lladroc	23
Inspektorati konfiskoi goma që përdoren në furrat e gëlqeres.....	23
Begaj priti drejtorin e kompanisë gjermane RTB GmbH, Rudolf Broher	24
Kryetari Begaj, priti komandantit e kontingjentit zviceran të KFOR-it, kolonelin Eichenberger	25
Shkolla “Visar Krasniqi” bëhet me bibliotekë shkollore	26
Vazhdon dezinfektimi i zonave endemike	27
Punëtorët e KEDS-it në Malishevë, ndihmojnë familjen Kryeziu nga Mleqani.....	28
Kryetari i Komunës, prezantoi raportin e punës për vitin e kaluar.....	28



Marsi, mbyllet edhe me një sukses të nxënësve malishevas

Malishevë, 1 prill

Nxënësit e Komunës së Malishevës, gjatë muajit mars, kanë korrur suksese në garat e diturisë. Gjatë fundjavës së kaluar, janë mbajtur garat e diturisë në lëndën e kimisë, ku nxënësi Erjon Morina, nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët, “Kajtaç Ramadani” në Kijevë, ka zënë vendin e parë në nivel republike.

Këtë sukses, të nxënësit Morina, e ka konfirmuar Drejtoria për Arsim dhe Edukim, në Komunën e Malishevës, përkatësisht drejtori Avdi Morina, i cili edhe e ka urreuar nxënësin për këtë rezultat të treguar në garat e diturisë.

“Qëllim i yni është rritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe për këtë jemi duke punuar maksimalisht si drejtori. Këtë angazhim, më së miri po e prezantojnë nxënësit tanë me rezultat që janë duke treguar, dhe unë me këtë rast, e uroj nxënësin Erjon Morina, për këtë sukses”, tha Morina.

Garat në lëndën e Kimisë, janë mbajtur në kolegjin “Mehmet Akif”, ndërsa këto gara janë tradicionale dhe organizohen në bashkëpunim me MASHTK.

Administrata komunale shënoi Ditën e Pastërtisë

Malishevë, 1 prill



Organizuar nga Drejtoria Komunale e Shërbimeve Publike dhe të prirë nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, punëtorët e administratës komunale në Malishevë, në mënyrë simbolike kanë shënuar 1 Prillin, Ditën e Pastërtisë së Ambientit. Me këtë rast, punëtorët e administratës, kanë hequr mbeturinat në ambientet e hapura në parkun e qytetit dhe në vende të caktuara në qytet.

Edhe pse përgjatë rrugëve kryesore dhe parqet e qytetit, kryesisht janë pastruara mirë, megjithatë, në vende të caktuara, herë pas here ka mbeturina të hedhura nga persona të cilët nuk i hedhin mbeturinat në kontejnerët e vendosura përgjatë rrugëve apo edhe në park.



Përndryshe, pastrimi i ambientit, vazhdon të mbetet një prej prioriteteve të qeverisë komunale, edhe për këtë vit.

Faza e parë e repelimit të kafshëve, përfundon këtë javë

Malishevë, 4 prill

Sikur çdo të hënë, edhe sot, është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, i udhëhequr nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj. Në këtë mbledhje, bazuar në raportimet e drejtorive, u bë e ditur, se faza e parë e repelimit të kafshëve, si masë parandaluese nga ethet hemorragjike, përfundon të mërkurën, ndërsa i tërë procesi, u vlerësua i suksesshëm.

Sipas shtabit komunal, për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo, procesi i repelimit të kafshëve, është në përfundim, ku gjatë ditës së nesërme përfundon edhe fshati i fundit, ndërsa të mërkurën, do të bëhet repelimi në ato raste, ku për shkaqe të ndryshme nuk ka mundur të kryhet ky proces. Përndryshe, sipas drejtorisë së shëndetësisë, deri më tani janë të regjistruara 22 raste të thumbimeve nga rriqrat.

Në këtë mbledhje, u bë e ditur se shumë shpejt, pritet të filloj edhe largimi i deponive ilegale të mbeturinave, ndërsa gjatë muajit prill, drejtoria e shërbimeve publike, do të jetë e angazhuar në këtë drejtim, pasi paraprakisht i kanë evidentuar këto deponi.

Sa i përket investimeve kapitale, u bë e ditur, se tashmë kanë përfunduar ndërtimet e trotuareve në Damanek dhe Bubavec, kurse ndërtimi i shkollave, është duke vazhduar në Gurishtë dhe Bubavec, të cilat shumë shpejt do të jenë të gatshme, sikur po vazhdojnë punimet në ndërtimin e dy fushave sportive në shkollat e Llapqevës dhe Senikut.

Begaj dhe Morina, panë nga afër realizimin e disa projekteve

Malishevë, 5 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, z.Ahmet Morina, sot kanë vizituar disa nga vend punimet, ku janë duke u realizuar disa nga projektet kapitale, për tu njoftuar me ecurinë e këtyre projekteve. Begaj e Morina, janë ndarë të kënaqur me realizimin e projekteve, të cilat i kanë vizituar.



Kryetari Begaj dhe drejtori Morina, i kanë vizituar punimet në rregullimin e segmenteve të rrugëve në lagjen Mirdita në Malishevë, pastaj shkollën në Astrazup, rrugën Marali-Gajrak dhe punimet në shkollën e Banjës, ku janë takuar edhe përgjegjësit shkollave, si dhe punëkryesit, duke u njoftuar drejtpërdrejt me ecurinë e punimeve.



Në këto projekte, të cilat në janë realizim e sipër, punët janë duke vazhduar sipas dinamikës së paraparë, dhe brenda afateve të përcaktuara. Banorët e këtyre vendbanimeve, janë shprehur të kënaqur me punimet që janë duke u zhvilluar, pasi nevoja ka qenë e madhe për këto projekte, si në rrugët, trotuaret, apo shkollat.

Në të dy shkollat që janë duke u ndërtuar, njëra objekt komplet (Astrazup) dhe tjetra aneks (Banjë), pritet që pas ndërtimit, mësimi të zhvillohet në një ndërrim dhe sipas standardeve, ndërsa në rrugët e lagjes Mirdita, aktualisht janë duke u përgatitur për ndërtimin trotuareve dhe më pas asfaltimi i tyre, dhe rruga Marali-Gajrak, është e rregulluar dhe pritet vetëm asfaltimi i saj.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, miratoi raportin financiar për vitin 2015

Malishevë, 6 prill



Sot është mbajtur mbledhja e tretë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Malishevës, e cila është drejtuar nga kryesuesi i saj, Aziz Thaçi. Në këtë mbledhje, janë marrë disa vendime, është miratuar raporti financiar për vitin 2015, pastaj është miratuar plani komunal për efikasitet të energjisë, si dhe është shfuqizuar vendimi i mëhershëm për kushtëzimin e qytetarëve, me pagesat e shërbimit të grumbullimit të



mbeturinave.

Fillimisht, KK i Malishevës, ka miratuar kërkesat e dy qytetarëve për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, ndërsa më pas shqyrtimit të raportit financiar për vitin 2015, e ka miratuar këtë raport. Në këtë mbledhje, anëtarët e KK-së, janë informuar edhe për përfundimin gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2015-2016.

Po ashtu në këtë mbledhje, anëtarët e Kuvendit të Malishevës, me kërkesë të MAPL-së, pas rishqyrtimit, kanë shfuqizuar vendimin e mëhershëm për kushtëzimin e qytetarëve, lidhur me shërbimet komunale të mbeturinave.

KK ka miratuar edhe planin komunal për efikasitet të energjisë 2016-2020. Me kërkesë të Asociacionit të Komunave të Kosovës, KK i Malishevës, ka formuar një komision për harmonizimin e propozimit të KK të Malishevës, lidhur me pagat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Gjithashtu, KK i Malishevës, ka dhënë pëlqimin e një kërkesë të një qytetari, për ndërtimin e një sistemi për ujtitjen e plantacioneve me mollë.

Ndërsa kërkesa e një qytetari, për ndërrim të paluajtshmërisë të pronës private me pronë publike, ka mbetur për interpretim nga ana e MAPL-së, pasi ajo kërkesë mori një votë kundër, një pro, 18 të tjerë kanë abstenuar, ndërsa dy anëtar të KK-së (LVV), nuk morën pjesë në votim.

Projekti i Pajtim Bytyqit, më i miri në “International Conference GREDIT 2016”

Malishevë, 7 prill



Komuna e Malishevës, e ka përkrahur realizimin e një projekti studimor të realizuar nga studiuesi Pajtim Bytyqi nga fshati Shkozë, Komuna e Malishevës dhe ky studim, në mesin e 240 punimeve tjera studimore, e ka zënë vendin e parë në konferencën ndërkombëtare “Gredit 2016”. Ky studim, është edhe një sukses i radhës i të rinjve tanë, të cilët çdo ditë e më tepër po i tregojnë aftësitë e tyre në shkencë.

“Ndihej tejet i lumtur, që në mesin e 240 punimeve studimore në "International Conference GREDIT 2016", ku u shpërblyem me vendin e parë, si artikulli më i kësaj konference. Më vjen mirë që promovova vendin tim, duke treguar vlerat e “biodiversitetit që posedon vendi im Shkoza”, ka deklaruar autori i këtij studimi, Pajtim Bytyqi. Autori, me këtë rast falënderon edhe



prof.Ferdije Zushi-Etemi për punën e palodhshme që ka bërë rreth këtij punimi dhe kolegun e tij Milaim Musliu, për ndihmën e dhënë gjatë përgatitjes së këtij punimi.

Autori Bytyqi, ka falënderuar e Komunën e Malishevës, për mbështetjen e dhënë në realizimin e projektit të tij, për studimin e biodiversitetit, përkatësisht “The composition of the daily butterflies in the village Shkoza in Malisheva (Përbërja e fluturave ditore në fshatin Shkozë të Malishevës)”.

Me këtë rast edhe Komuna e Malishevës, i uron suksese të mëtutjeshme studiuesit Bytyqi, dhe zotohet që gjithmonë do të mundohet ti përkrah të gjithë ata që merren me hulumtime shkencore, e në veçanti ata që kontribuojnë për vendin, hulumtime përmes së cilave tregohet edhe pasuria e natyrës së gjallë në Komunën e Malishevës.

Mërgimtari Bashkim Shala, i dhuroi kabinet të informatikës, shkollës në Guncat

Malishevë, 7 prill



Se mërgimtarët tanë, që jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme, vazhdojnë të ndihmojnë në zhvillimet e përgjithshme të vendit, e dëshmon edhe ndihma e fundit e mërgimtarit Bashkim Shala, nga fshati Guncat, i cili, shkollën e vendlindjes së tij “Dëshmorët e Kombit”, e ka bërë me kabinet të informatikës, duke dhuruar dhjetë kompjuter.

Këtë donacion, të mërgimtarit Shala, e ka konfirmuar Drejtoria Komunale e Arsimit dhe me këtë drejtori i arsimit, Avdi Morina, e ka falënderuara Shalën, për këtë kontribut të tij, shumë domethënës për nxënësit e SHFMU “Dëshmorët e Kombit” në Guncat. “Në emër të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, e falënderojmë bashkatdhetarin Bashkim Shala, për këtë ndihmë, pasi nga tani e tutje, nxënësit e kësaj shkolle, do të kenë kushte më të mira për përvetësimin e lëndës së informatikës”, tha drejtorja Morina.

Ndërsa, edhe drejtori i SHFMU “Dëshmorët e Kombit”, Esat Zabelaj, e ka falënderuar mërgimtarin Bashkim Shala, si dhe ka falënderuar edhe Komunën e Malishevës, për sigurimin e



inventarit për kompjuter. “Mërgimtarin dhe bashkëfshatarin Bashkim Shala, e falënderojmë për zemërsisht për kontributin e dhënë për shkollën tonë. Gjithashtu falënderojmë edhe Komunën e Malishevës, përkatësisht Drejtorinë Komunale për Arsim dhe Edukim, për sigurimin e inventarit (tavolinave) për kompjuter”, thuhet në falënderimin e drejtorit të shkollës.

Kryetari Begaj: Dyert e hapura për qytetarë

Malishevë, 8 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sikur çdo të premte (si dhe ditëve tjera të javës), ka vazhduar ti mbajë dyert e hapura për qytetarët, të cilët dëshirojnë të takohen, ti shfaqin kërkesat e tyre, qoftë si individ, qoftë si komunitet, për çështje të caktuara. Për këtë qëllim kryetari Begaj, vazhdon traditën e mbajtjes së dyerve të hapura për qytetar, duke i dëgjuar hallet e tyre, por edhe duke u munduar që të ofroj mbështetjen e Kryetarit të Komunës, për të gjitha çështjet e adresuara.

Transparenca dhe afërsia me qytetarin, vazhdojnë të mbeten prioritetet e veçanta për kryetarin Begaj.

Gjatë ditës së sotme, kryetar Begaj, ka takuar shumë qytetar, të cilët kishin halle dhe nevoja të ndryshme, për ti shfaqur para kryetarit të komunës.

Në të gjitha rastet, kryetari Begaj, ju ka dhënë udhëzimet e nevojshme në raport me kërkesat e tyre, duke ju ofruar mbështetjen e zyrës së Kryetarit të Komunës. Varësisht prej rasteve, kryetari Begaj, është angazhuar, apo i ka udhëzuar të gjithë ata që sot e kanë takuar, direkt në zyrën e tij.

Malisheva, vazhdon të jetë komuna më e sigurt në vend

Malishevë, 12 prill

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ka mbajtur sot mbledhjen e dytë të radhës për këtë vit, ku është vlerësuar situata e sigurisë së përgjithshme. Këtë mbledhje e ka udhëhequr nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, sipas të cilit, duke u bazuar në raportet që kanë të bëjnë me sigurinë e përgjithshme, Komuna e Malishevës, vazhdon të mbetet komuna më e sigurt në vend.



Se situata e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Malishevës, është e qetë, stabile dhe pa elemente të prishjes së kësaj situatë, e ka konfirmuar edhe komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina. Kapiteni Morina, gjithashtu ka konfirmuar se ka “rënie të vazhdueshme të rasteve të krimeve në territorin e Komunës së Malishevës dhe se Malisheva prinë në raport me komunat tjera, sa i përket sigurisë së përgjithshme”.

Përndryshe në këtë mbledhje, u trajtua edhe nevoja për vendosjen e kamerave vëzhguese në hapësirat publike, pastaj problematika e qenve endacak, situata epidemiologjike nga ethet hemorgjike, përkatësisht përgatitjet për fillimin e spërkatjes selektive të zonave që cilësohen endemike dhe masat tjera, që janë të parapara me strategjinë kombëtare për luftimin dhe parandalimin e EHKK.

Kërvasaria mbledhi intelektualët e saj, për ti kujtuar dëshmorët

Malishevë, 10 prill

Kryesia e fshatit Kërvasari, përkatësisht kryetari i fshatit, z.Besnik Bytyçi, sot i ka organizuar të gjithë intelektualët e fshatit, për ti kujtuar dëshmorët dhe historinë e fshatit Kërvasari. Në këtë tubim të organizuar, krahas intelektualëve të këtij fshati, mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe qytetarët të tjerë.



Në hapjen e këtij tubimi, kryetari i fshatit, Besnik Bytyçi, tha se “qëllim i ynë ka qenë përkujtimi dhe nderimi për dëshmorët e fshatit, Sadri Abaz Bytyçi dhe Ramë Bytyçi, por, për të shënuar këtë ngjarje, kemi shprehur dëshirën që ta bëjmë me më të merituarit e Kërvasarisë, pasi fshati ynë ka kuadro të shumtë, të cilët janë shembull i mirë në tërë vendin”.

Më pas, për historinë fshatit dhe për dëshmorët, foli Adem Bytyçi. Sipas tij, “fshati Kërvasari ka një histori të begatshme, ku krahas dëshmorëve, në të gjitha periudhat, Kërvasaria ka dhënë atdhetar të shumtë, intelektualët e parë të kësaj rrethine, por edhe sot ka kuadro, si doktor



shkencash, inxhinier, gazetar, mjek e kuadro të tjera në të gjitha fushat, të cilët janë shembull i mirë, në tërë vendin”.

Duke marrë fjalën në këtë tubim, Kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, tha se “Kërvasaria është një vend simbol i intelektualëve të hershëm”, ndërsa duke folur për dëshmorët e kombit, Begaj tha se “nëse ne si komb e kujtojmë historinë tonë, i kujtojmë dëshmorët, atëherë të ardhmen e kemi të sigurt, pasi falë gjakut të dëshmorëve ne sot jetojmë të lirë”. Kryetari Begaj, foli me admirim për intelektualët e këtij fshati dhe kontributin tyre. Ai më pas foli edhe për situatën aktuale socio-ekonomike, ku u shpreh i pakënaqur me këtë situatë dhe i ftoi të gjithë, që të punojnë dhe kontribuojnë për vendin.

Në këtë takim u mbajtën edhe fjalime të tjera, ku u fol për historinë e këtij fshati, duke filluar nga emri i saj, si një vend ku kanë pushuar karvanet, për vazhduar me kontributin atdhetar të fshatit, në të gjitha periudhat, pastaj kontributin në përhapjen e librit shqip dhe shkollës shqipe, e deri te lufta e fundit. Në fund, kryetari i fshatit, Besnik Bytyçi, ka ndarë mirënjohje për të gjithë ata që kanë kontribuar dhe kontribuojnë në forma të ndryshme, e që vijnë nga fshati Kërvasari.

RSS

Nxënësit malishevas, mbajnë orë praktike në fushën e Astronomisë

Malishevë, 12 prill



Nxënësit e gjimnazit “Hamdi Berisha” dhe ata të SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, sot kanë mbajtur orë praktike në fushën e Astronomisë, orë të cilat i kanë mbajtur vullnetarët e klubit të astronomisë “Astronomy Outreach of Kosovo”, ndërsa këto dy shkolla kanë pranuar donacion edhe disa teleskop dhe syze solare, për praktikë.

Këtë aktivitet, e ka ndjekur edhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Avdi Morina, i cili i ka “falënderuar anëtarët e klubit të astronomisë, si dhe drejtuesi të këtyre dy shkollave, për realizimin e kësaj praktike, pasi është një fushë shkencore, për të cilën nxënësit tanë kanë nevojë të kenë më shumë njohuri, duke i parë edhe praktikisht përmes teleskopëve, lëvizjet në gjithësi dhe të mësojnë më shumë për trupat qiellor që e rrethojnë tokën”.

Ky aktivitet, është realizuar në bashkëpunim mes “Astronomy Outreach of Kosovo”, zyrës komunale për rini dhe drejtorisë për arsim dhe edukim.



Në këtë aktivitet, janë mbajtur orë mësimore praktike në fushën e astronomisë, ndërsa më pas edhe praktikisht, nxënësit, kanë mundur që përmes teleskopëve të sjellë nga ky klub i astronomëve, ta shikojnë diellin.

Filloi asfaltimi i rrugëve në Guncat

Malishevë, 13 prill



Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës në fshatrat e Komunës së Malishevës, sot ka filluar asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Guncat. Për këtë qëllim, nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, i shoqëruar nga drejtori i shërbimeve publike, z.Milazim Morina dhe ai i inspektoratit, z.Fadil Shala, e kanë vizituar sot Guncatin, ku i kanë uruar banorët për asfaltimin e rrugëve në fshatin e tyre.

“Në emër të Komunës së Malishevës, ju uroj për asfaltimin e rrugëve, projekt ky i cili është në shërbim të qytetarëve dhe për rritjen e mirëqenies së qytetarëve, që ju lehtëson lëvizjen tuaj. Guncati e ka merituar këtë, pasi jeni një prej fshatrave më të thella të komunë sonë dhe lehtësim i lëvizjes dhe qëndrimi në fshatin tuaj të lindjes, është detyrim për neve”, tha nënkryetari i Malishevës, Rexhep Mazreku.

Nga ana tjetër, banorët e fshatit, e kanë falënderuar nënkryetarin Mazreku, për realizimin e këtij projekti, domethënë për banorët e Guncatit, pasi me rregullimin e rrugëve dhe infrastrukturës tjetër përcjellëse, jetesa në fshatrat si në Guncat, bëhet me e lehtë dhe banorët nuk kanë nevojë të dynden në qendrat më të mëdha, por të jetojnë në vendin e lindjes.



Delegacioni i Malishevës, vazhdon vizitën në Slloveni

Malishevë/Lubjanë, 13 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, z.Ahmet Morina, po vazhdojnë vizitën disa ditore në Slloveni, ku po qëndrojnë me ftesë të klubit të biznesit slloven. Gjatë ditës së sotme, kryetari Begaj dhe drejtori Morina, kanë vizituar disa nga kompanitë sllovene, me të cilët kanë biseduar për mundësitë bashkëpunimit me Komunën e Malishevës. Delegacioni nga Malisheva, po shoqërohet nga përfaqësuesja e klubit të bizneseve sllovene dhe kosovare, znj.Sonja Rutar.

Gjatë ditës së sotme, Begaj dhe Morina, kanë vizituar kompaninë “Hidroinzhinering” në Lubjanë, ku janë takuar me drejtorin e saj, z.Boris Savnik dhe menaxhmentin e kësaj kompanie, ndër më të njohurat në Evropë, për trajtimin e ujërave dhe ndërtimin e impianteve, ku janë njohur me mundësitë që ka kjo kompani, e cila gjatë muajit shkurt, kishte qëndruar në Malishevë, pikërisht për të parë mundësinë e investimit në këtë fushë.

Më pas, Begaj e Morina, të shoqëruar nga klubi i bizneseve në Slloveni, kanë vazhduar vizitat në disa nga kompanitë dhe fermat më të mëdha në këtë vend, si në kompaninë “Autocommerce”, përfaqësuese e Mercedesit dhe Fordit për Slloveni, pastaj ferma tjera, të cilat njihen me produktet e qumështit dhe mishit.

Delegacioni i Malishevës, vazhdon vizitën në Slloveni

Malishevë/Lubjanë, 13 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, z.Ahmet Morina, po vazhdojnë vizitën disa ditore në Slloveni, ku po qëndrojnë me ftesë të klubit të biznesit slloven. Gjatë ditës së sotme, kryetari Begaj dhe drejtori Morina, kanë vizituar disa nga kompanitë sllovene, me të cilët kanë biseduar për mundësitë bashkëpunimit me Komunën e Malishevës. Delegacioni nga Malisheva, po shoqërohet nga përfaqësuesja e klubit të bizneseve sllovene dhe kosovare, znj.Sonja Rutar.



Gjatë ditës së sotme, Begaj dhe Morina, kanë vizituar kompaninë “Hidroinzhineri” në Lubjanë, ku janë takuar me drejtorin e saj, z.Boris Savnik dhe menaxhmentin e kësaj kompanie, ndër më të njohurat në Evropë, për trajtimin e ujërave dhe ndërtimin e impianteve, ku janë njohur me mundësitë që ka kjo kompani, e cila gjatë muajit shkurt, kishte qëndruar në Malishevë, pikërisht për të parë mundësinë e investimit në këtë fushë.

Më pas, Begaj e Morina, të shoqëruar nga klubi i bizneseve në Slloveni, kanë vazhduar vizitat në disa nga kompanitë dhe fermat më të mëdha në këtë vend, si në kompaninë “Autocommerce”, përfaqësuese e Mercedesit dhe Fordit për Slloveni, pastaj ferma tjera, të cilat njihen me produktet e qumështit dhe mishit.

U hap çerdhja e parë publike në Malishevë

Malishevë, 15 prill



Sot në qytetin e Malishevës, ishte një ditë e veçantë, sepse ky qytet nga sot, për herë të parë bëhet me çerdhe publike për fëmijë. Për këtë qëllim, është mbajtur edhe një ceremoni për hapjen zyrtare të çerdes, ku morën pjesë, strukturat komunale të prira nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, pastaj deputetët e Kuvendit të Kosovës, z.Enver Hoti, znj.Valdete Bajrami dhe znj.Shukrie Bytyçi, si dhe qytetarë e prindër të shumtë.

“Jam shumë i kënaqur, që për herë të parë në Malishevë, po e hapim një çerdhe për fëmijë. Kemi dhënë maksimumin për ndërtimin dhe hapjen e çerdes dhe kjo është e arritur e jona, në kuadër të të arriturave në arsim, dhe për këtë jam krenar. Ne kemi dhënë mundim tonë për ndërtimin e kësaj çerde, por tani është përgjegjësi e menaxhmentit dhe edukatoreve, që ta mbajnë këtë”, tha kryetari Begaj, duke i porositur punonjëset e çerdes, për mirëmbajtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve. “Kjo çerdhe është tepër e rëndësishme, në veçanti për nënat të cilat janë të angazhuara në punë dhe obligim i yni është që ta mbajmë këtë institucion parashkollor”, tha Begaj, në ceremoninë e hapjes së çerdes.

Ndërsa deputetja e Kuvendit të Kosovës, znj.Shukrie Bytyçi, tha se “na ka munguar një institucion i tillë, sidomos për gratë që punojnë”, e cila i uroi të gjithë për hapjen e kësaj çerde.



Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Avdi Morina, duke marrë fjalën, tha se “për herë të parë në qytetin e Malishevës, po hapet një institucion i këtillë parashkollorë, ku do të hyjnë fëmijët e moshës nëntë muaj, deri në atë pesë vjeçare”. Drejtori Morina, tha se “do të jetë i përkushtuar për punën e çerdhes dhe funksionimin e mirë të saj”.

E përkushtim për çerdhen do të ketë drejtoresha e çerdhes së parë për fëmijë në Malishevë, znj.Valbona Hoti. Ajo tha se “do të bashkëpunoj mirë me prindër dhe do të jetë shumë e përkushtuar me drejtimin e çerdhes”. Drejtoresha Hoti, e falënderoi kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, për përkrahjen e tij, në ndërtimin dhe hapjen e çerdhes së parë në Malishevë.

Kjo çerdhe ka një kapacitet për pranimin e tetëdhjetë fëmijëve dhe është ndërtuar nga buxheti i Komunës së Malishevës, e cila ka kushtuar rreth 140 mijë euro.

Aktualisht po realizohen projekte në shtatëdhjetë për qind të fshatrave

Malishevë, 18 prill

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, u bë e ditur se po vazhdohet me realizimin projekteve të ndryshme dhe aktualisht, kur jemi në muajin e katërt të këtij viti, janë duke u realizuar projekte të ndryshme në shtatëdhjetë për qind të vendbanimeve të Komunës së Malishevës dhe shumë shpejt, do të vazhdohet edhe me projekte tjera.

Këtë të dhënë, e dha sot drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Ahmet Morina, sipas të cilit, në të gjitha projektet që janë në realizimin, mbarëvajtja e punimeve po ecën mirë, përjashtuar ndonjë ngecje, për shkaqe objektive, dhe se shumë shpejt pritet të fillojnë të realizohen edhe projekte tjera, ku do të përfshihen, pothuajse të gjitha vendbanimet.

Temë e pashmangshme e mbledhjes së sotme ishte edhe situata epidemiologjike, ku kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kërkoi angazhimin e të gjithë sektorëve, në mënyrë që edhe ky vit të kaloj si dy vitet e mëparshme, pa viktima dhe pa raste të infektimit. Për këtë çështje, kryetari Begaj, paralajmëroi se krahas aktiviteteve aktuale, do të rritet edhe më shumë kontakti me qytetar, në mënyrë që të vetëdijesohemi edhe më tepër për rrezikun nga rriqrat, si bartës të virusit të etheve hemorragjike krime kongo (EHKK).

Për këtë qëllim, drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, tha se janë shumë të përkushtuar në këtë drejtim, dhe janë duke u bërë fushata të ndryshme, duke filluar nga cikli i parë i repelimit të kafshëve, për të vazhduar me fushatën e ligjëratave vetëdijesuese në shkollat e komunës, ndërsa



nga kjo javë do të filloj edhe faza e parë e dezinsketimit të zonave endemike dhe shumë shpejt edhe pritet të filloj edhe cikli i dytë i repelimit të kafshëve.

Përndryshe, në mbledhjen e sotme, drejtorët e drejtorive, kanë raportuar për aktivitetet e rregullta të drejtorive që drejtojnë, realizimin e objektivave dhe planifikimeve që kanë bërë për këtë vit.

Asfaltohet edhe një rrugë në Pagarushë

Malishevë, 19 prill



Sot në fshatin Pagarushë, përkatësisht në lagjen Bajdan, ka filluar asfaltimi i rrugës së kësaj lagjeje, e cila lidhet me rrugën kryesore të fshatit. Asfaltimi i kësaj rruge, është në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në Komunën e Malishevës, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira, për të gjithë banorët. Asfaltimin e rrugës, e ka parë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili i ka uruar

banorët e kësaj lagjeje, për rrugën.

Kryetari Begaj, ishte i shoqëruar edhe nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina dhe zyrtarë tjerë përgjegjës, të cilët e kanë parë nga afër shtrimin e rrugës dhe cilësinë e punimeve.

Me këtë rast, kryetari Begaj, i ka uruar banorët e kësaj lagjeje, banorët e së cilës, nga sot, e kanë më të lehtë lëvizjen, pasi rrugën kryesore të fshatit, e kanë rreth tetëqind metra larg. “Qëllimi i yni është rritja e mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Malishevës, pa dallime, prandaj edhe kjo rrugë që sot kemi mundësi ta asfaltojmë, është në kuadër të përpjekjeve tona për rritjen e mirëqenies dhe krijimit të kushteve më të mira, në këtë rast, për lëvizjen tuaj më të lehtë dhe pa probleme”, tha kryetari Begaj.

Nga ana tjetër, banorët e kësaj lagjeje, e kanë falënderuar kryetarin Begaj, për angazhimin e tij në rregullimin e rrugës së kësaj lagjeje, pasi gjithmonë kanë pasur problem qarkullimin, sidomos kur ta të reshura atmosferike. Sipas tyre, askush deri më tani nuk ishte interesuar për banorët e kësaj lagjeje, dhe kjo që sot po bëhet, është shumë e dobishme për ta.



Përndryshe, fshati Pagarushë, është prej fshatrave të mëdha të Komunës së Malishevës, por karakteristikë e këtij fshati është relievi i thyer dhe largësia mes lagjeve, të cilat gjenden me kilometra larg njëra tjetrës. Rruga kryesore e kësaj lagje, që lidhet me rrugën kryesore të fshatit, është e gjatë afër 800 metra.

Kryetari Begaj, priti përfaqësuesin e klubit të shqiptarëve në Sundern të Gjermanisë, Fadil Bytyçin

Malishevë, 20 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim, kryetarin e klubit të shqiptarëve “2 Korriku”, në Sundern të Gjermanisë, z.Fadil Bytyçi, me të cilin biseduan për aktivitetet e përbashkëta, të zhvilluara, mes Komunës së Malishevës dhe Komunës së Sundernit, dhe për kontributin e kësaj shoqate, në krijimin e lidhjeve disa vjeçare mes dy komunave.

Me këtë rast, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, e ka falënderuar Bytyçin, për vizitën në Malishevë dhe për kontributin që klub i shqiptarëve “2 Korriku”, po jep në Sundern të Gjermanisë, në forcimin e lidhjeve mes dy komunave dhe në vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë, si për kontributin e “2 Korrikut”, në organizimin e komunitetit shqiptar në këtë pjesë të Gjermanisë.

Edhe kryetari i klubit “2 Korriku”, z.Fadil Bytyçi, e ka falënderuar Komunën e Malishevës dhe kryetarin Begaj, për pritjen, si dhe për vizitën e mëhershme të një delegacioni nga Malisheva, në Sundern, ku janë takuar edhe me udhëheqësit lokal, por edhe me komunitetin e shqiptarëve që jetojnë dhe veprojnë në Gjermani, përkatësisht në Sundern dhe rrethinë.

Begaj e Bytyçi, u zotuan për vazhdimin e bashkëpunimit si me shqiptarët në Gjermani, e po ashtu edhe me autoritetet e Sundernit, ku gjatë këtij viti, pritet që një delegacion nga Sunderni, ta vizitoj Malishevën, në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë.



Deri në fund të vitit, parashihet të përfundoj projekti i ujësjellësit për 14 fshatra të Malishevës

Malishevë, 20 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën e tij, drejtuesit e Hidroregjionit jugor dhe ata të DIC-së, si implementues të programit qeveritar zviceran, për ndërtimin e ujësjellësit për 14 fshatra të Komunës së Malishevës, nga ujëmbledhësi i Senikut. Në këtë takim, u tha se hartimi i projektit final ka përfunduar dhe nga fundi i majit, pritet edhe fillimi i implementimit.

Në këtë projekt të ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit, planifikohet të ndërtohet rrjeti i ujësjellësit, i gjatë rreth 120 kilometra, për 14 fshatra, me mbi 20 mijë banorë dhe pritet të kushtoj mbi 1.1 milion euro, i cili financohet nga zviceranët. Ky projekt do të ndërtohet në disa faza, dhe nëse gjithçka shkon sipas planifikimeve, deri në fund të vitit, pritet edhe të përfundoj projekti për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit, por në këtë projekt nuk parashihen kycje individuale, të cilat do të kryhen në një fazë tjetër.

Në këtë rast, duke i falënderuar për finalizimin hartimit të projektit, kryetari Begaj, tha se “Malisheva është në kushte të vështira në këtë drejtim, pasi nuk kemi trashëguar asnjë metër sistem të ujësjellësve dhe çdo gjë është dashur të ndërtohet nga fillimi, për secilin vendbanim, dhe ky projekt tani, është shumë i mirëseardhur për banorët e këtyre fshatrave, pasi uji është edhe burim i jetës për mbi 20 mijë banorët e këtyre fshatrave”.

Ndërsa Besim Baraliu, drejtor i Hidroregjionit jugor, tha se “ pikërisht kjo situatë në Malishevë, na ka bërë që këtë komunë ta kemi edhe si prioritet në planifikimet e kompanisë së Hidroregjionit jugor”.



Edhe përfaqësuesi i Dorsch International Consultants, Alan Brown, si implementues i projektit të qeverisë zvicerane në Kosovë, për ndërtimin e sistemeve të ujësjellësve, u shpreh i kënaqur, që kanë arritur në këtë fazë të këtij projekti dhe uroi që çdo gjë të shkojë sipas planifikimeve.

Përndryshe, në këtë takim, u bë e ditur se edhe projekti i rehabilitimit të 11 ujësjellësve ekzistues, për Komunën e Malishevës, është në fazat e tenderimit dhe sipas përfaqësuesve të Hidroregjionit jugor, edhe ky projekt pritet të përfundojë brenda këtij viti.

Filloi dezinfektimi selektiv kundër rriqrave

Malishevë, 20 prill



Në kuadër të zbatimit të strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), nga sot, në territorin e Komunës së Malishevës, ka filluar dezinfektimi selektiv kundër rriqrave, në zonat që cilësohen endemike. Dezinfektimin, është duke e kryer kompania “Truly Nolen”, e cila është e kontraktuar nga Ministria e Bujqësisë. Ky dezinfektim, po bëhet krahas fushatave tjera, për luftimin dhe

parandalimin e EHKK.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe anëtarit i shtabit komunal për luftimin dhe parandalimin e EHKK, Hajdin Berisha, në ditën e parë e këtij dezinfektimi, çdo gjë ka shkuar mirë. “Ky dezinfektim, është duke u kryer krahas aktiviteteve tjera që janë duke u zhvilluar në terren për luftimin e këtij virusi. Aktualisht, janë duke u zhvilluar fushata vetëdijesuese nëpër të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës, për rrezikun nga thumbimi i rriqrave, si bartës të virusit që shkakton ethe hemorragjike. Po ashtu nga nesër, fillon edhe cikli i dytë i repelimit të kafshëve, në mënyrë që të parandalohet bartja e rriqrave përmes kafshëve”, tha drejtori Berisha.

Ethe hemorragjike krime kongo (EHKK), përcillen përmes rriqrave tek njeriu dhe nëse rriqra është e infektuar me virus, atëherë ai virus përcillet tek njeriu, që mund të jetë vdekjeprurës.

Sipas drejtorit Berisha, “deri më sot, janë regjistruar 84 raste të thumbimeve nga rriqrat, por situata është normale dhe nuk ka vend për shqetësim, pasi asnjë rast nuk është i infektuar, ndërsa



në të njëjtën kohë, janë duke u marrë të gjitha masat parandaluese, por edhe masat e trajtimit, për rastet e thumbimeve”. Ai po ashtu tha se, shtabi komunal është duke i bashkërenduar aktivitetet me organet qendrore përgjegjëse dhe me këshillin ndërmintor për luftimin dhe parandalimin e EHKK.

U mbajt krosi pranveror në Malishevë, ku morën pjesë 350 garues

Malishevë, 20 prill



Në organizim të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Shoqatës së Pedagogëve të Sportit Shkollor të Komunes së Malishevës, sot u mbajt krosi pranveror për shkollat fillore, të mesme dhe për qytetar. Ky kros është tradicional dhe organizohet çdo vit. Në këtë kros morën pjesë mbi 350 garues nga shkollat fillore, të mesme dhe qytetarë.

Për më të mirët e këtij krosi janë ndarë mirënjohje dhe medalje.

Rezultatet:



Fituesit e krosit pranveror 2016

Shkollat filllore

Femra, klasët 6, 7

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla
1	Sofie	Kafexholli	Ismail Qemali
2	Ronesa	Javori	Gjergj Kastriotit
3	Kujtesa	Krasniqi	Hasan Prishtina

Meshkuj klasët 6, 7

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla
1	Lek	Mazreku	Ibrahim Mazreku
2	Egzon	Krasniqi	Hasan Prishtina
3	Ideal	Mazreku	Ibrahim Mazreku

Femra, klasët 8, 9

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla
1	Fatjone	Krasniqi	Vesel Pagarusha
2	Fortesa	Berisha	Habib Berisha
3	Alma	Hoxha	Ismail Qemali

Meshkuj klasët 8, 9

Nr	Emri	Mbiemri	Shklla
1	Albin	Hoti	Ibrahim Mazreku
2	Fatlind	Krasniqi	Hasan Prishtina
3	Liman	Morina	18 Prilli

Koordinatori për organizimin e krosit: Adrian Mazreku

Shkollat e mesme

Femra

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla
1	Edonisa	Shala	QK "Kujtim Krasniqi"
2	Ardita	Berisha	GJ "Hamdi Berisha"
3	Arta	Thaçi0	GJ "Hamdi Berisha"

Meshkuj

Nr	Emri	Mbiemri	Shkolla
1	Flamur	Foniqi	GJ "Hamdi Berisha"



2	Hidajet	Gashi	“Lasgush Poradeci”
3	Gentian	Foniqi	“Lasgush Poradeci”

Qytetare - Femra

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi
1	Arbnore	Berisha	Gurbardh
2	Drenusha	Berisha	Gurbardh
3	Fatjona	Krasniqi	Terpeze

Qytetar - Meshkuj

Nr	Emri	Mbiemri	Vendi
1	Grevist	Bytyqi	Kervasari
2	Hasan	Jonuzaj	Senik
3	Blendon	Kryeziu	Mleqan

Koordinatori për organizimin e krosit: Adrian Mazreku

Komiteti për Politikë Financa, mbajti mbledhjen e rregullt

Malishevë, 21 prill

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt, ku janë trajtuar disa çështje, si dhe janë dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Fillimisht në këtë mbledhje, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka prezantuar raportin e punës së Kryetarit dhe Qeverisë Komunale, për vitin 2015, raport të cilin anëtarët e KPF-së, e vlerësuan si gjithëpërfshirës, ndërsa i njëjti raport, do të shqyrtohet edhe në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës s Malishevës.

Për mbledhjen e ardhshme të kuvendit, është rekomanduar edhe kërkesa e KDI-së, për iniciimin e procedurave për ndryshimin e rregullores Komunale për Transparencë, si dhe raporti komumulativ i punës së Zyrës së Tatimit në Pronë, për vitin 2015.



Vazhdojnë aktivitetet për parandalimin e EHKK

Malishevë, 22 prill



Në Komunën e Malishevës, janë duke vazhduar aktivitetet e shumta, në kuadër të zbatimit të strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo. Në kuadër të këtyre aktiviteve, aktualisht janë duke u bërë dezinsketimi selektiv i zonave endemike, në atë zona ku më shumë raste thumbimeve, po vazhdohet me ciklin e dytë të repelimit të kafshëve, si dhe janë duke u mbajtur

ligjërrata vetëdijesimi në të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës.

“Parandalimi është masa më e sigurt dhe më e lehtë, prandaj, së bashku me institucionet në të gjitha nivelet, jemi të angazhuar në këtë drejtim”, ka deklaruar Hajdin Berisha, drejtor për shëndetësi dhe anëtar i shtabit komunal për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK). Me këtë rast drejtori Berisha i ka falënderuar të gjithë ata që janë të angazhuar në këto aktivitete.

Për të parandaluar EHKK-në, në shkollat e Komunës së Malishevës, po mbahen ligjërrata, në mënyrë që të vetëdijesohen, sidomos fëmijët, të cilët edhe janë më të ekspozuar në natyrë dhe kontakti më rriqra, si bartës të EHKK, është më i mundshëm. Në këto aktivitete të ligjëratave në shkolla, janë të angazhuar zyrtarë nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP), Instituti Rajonal i Shëndetit Publik (IRSHP) në Prizren dhe profesionistët nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Malishevë.

Në këtë fushatë, drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, Hajdin Berisha, e ka refuzuar pjesëmarrjen e Institutit Rajonal të Shëndetit Publik (IRSHP) në Gjakovë, pasi Komuna e Malishevës, nuk e pranon regjionalizimin me Gjakovën, gjë të cilën e kanë shprehur haptas edhe popullata edhe zyrtarët komunal të Malishevës. “Unë i falënderoj zyrtarët e IRSHP në Gjakovë, për gatishmërinë e tyre në dhënien e kontributit në këtë drejtim, mirëpo ne i përgjigjemi IRSHP në Prizren dhe nuk e pranojmë që edhe në këtë sektor të regjionalizohemi, pasi lidhjet tona janë me Prizrenin”, ka thënë drejtori Berisha.



Përfundoi dezinfektimi kundër rriqrave në Lladroc

Malishevë, 22 prill

Sot ka përfunduar dezinfektimi kundër rriqrave, në fshatin Lladroc. Kjo fushatë e dezinfektimit, është duke u kryer në kuadër të zbatimit të strategjisë për luftimin dhe parandalimin e EHKK, ndërsa rriqrat janë bartës së virusit dhe kjo është arsyeja e dezinfektimit. Paraprakisht, dezinfektimi është kryer në Carrallukë dhe Shkarashnik, ndërsa nesër pritet të bëhet dezinfektimi në fshatin Senik.

Dezinfektimi, kryhet nga një kompani e caktuar nga Ministria e Bujqësisë, ndërsa monitorimin e kësaj fushate të dezinfektimit, janë duke e bërë zyrtarët komunal të Malishevës. Për këtë qëllim, edhe sot këtë fushatë të spërkatjes së zonave endemike, e ka përcjellë nga afër drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, Hajdin Berisha, kurse në monitorim të vazhdueshëm, është edhe Halit Mazreku, zyrtar në drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Sipas të dhënave në terren, qytetarët janë të kënaqur me mënyrën e realizimit të dezinfektimit dhe nuk është shënuar asnjë problem.

Zyrtarët komunal të Malishevës, ju bëjnë thirrje qytetarëve për bashkëpunim gjatë kësaj fushate të dezinfektimit, ndërsa lusin bletarët, që të bëjnë kujdes të shtuar për bletët.

Inspektorati konfiskoi goma që përdoren në furrat e gëlqeres

Malishevë, 25 prill

Sot është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve në Komunën e Malishevës, i udhëhequr nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj. Në këtë mbledhje, drejtorët e drejtorive, kanë raportuar për aktivitetet gjatë javës së kaluar dhe planifikimet për javën në vijim. Në këtë mbledhje u bë e ditur, se gjatë javës së kaluar, inspektorët komunal, kanë konfiskuar një sasi të madhe të gomave, në njërin nga furrat për përfitimin e gëlqeres.

Sipas drejtorit të Drejtorisë së Inspektoratit, Fadil Shala, inspektorët komunal, në bashkëpunim me organet tjera, kanë konfiskuar rreth 500 goma të vjetra, në njërin prej furrave për përfitim të



gëlqeres, në fshatin Guncat. Pronarët e këtyre furrave, në shumë raste përdorin goma të vjetra, gjë e cila është e ndaluar, për shkak të ndotjes së ambientit.

Përndryshe, në mbledhjen e sotme, u tha se janë duke vazhduar me realizimin e projekteve në infrastrukturën e përgjithshme, si në shkolla, rrugë, kanalizime dhe projekte tjera, me rëndësi për banorët e Komunës së Malishevës, ndërsa shumë shpejt pritet të bëhet edhe pranimi i mbi njëzet projekteve të realizuara.

Po ashtu, u raportua edhe për situatën epidemiologjike, ku u tha se po vazhdojnë me fushatat sensibilizuese dhe vetëdijesuese kundër EHKK, pastaj repelimi i kafshëve dhe dezinfektimi selektiv i zonave endemike, dhe se situata është normale, dhe pavarësisht prej rasteve të thumbimeve nga rriqrat, nuk ka raste të infektimit.

Në këtë mbledhje, gjithashtu u tha se në shkollat e komunës sonë, kanë filluar garat sportive të cilat organizohen në bashkëpunim me shoqatën e pedagogëve sportiv, pastaj kanë filluar përgatitjet për testet e fundvitit shkollor, kurse në fushën e sportit, u tha se ekipet garuese në ligat e Kosovës, po vazhdojnë në rezultate të mira, sidomos në shah dhe hendboll.

Ndërsa drejtorja e shërbimeve publike, bëri të ditur, se janë duke vazhduar me implementimin e projektit të gjelbërimit, ku janë duke u gjelbëruar disa nga hapësirat publike.

Sot në mbledhjen e rregullt të Këshillit të drejtorëve, u prezantuan edhe dy ndryshimet në qeverinë komunale, ku drejtor i administratës, është emëruar Hajrullah Mazreku, ish drejtor për bujqësi, ndërsa drejtor për bujqësi, është emëruar Haxhi Krasniqi.

Begaj priti drejtorin e kompanisë gjermane RTB GmbH, Rudolf Broher

Malishevë, 26 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot drejtorin e kompanisë gjermane RTB GmbH & CO.KG, z.Rudolf Broher, me të cilin biseduan për mundësitë e investimeve në Malishevë, si dhe për mundësinë e ndihmës në sektorin social, përkatësisht në shëndetësinë e Komunës së Malishevës. Begaj dhe Broher, kanë vizituar disa nga





institucionet lokale në Malishevë.

Kryetari Begaj, e falënderoi pronarin e RTB, Rudolf Broher, për vizitën në Malishevë dhe për interesimin e tij, si dhe për pritjen që kjo kompani i ka bërë delegacionit nga Malisheva, muaj më parë në Gjermani, ku në mesin e shumë vizitave, ishte edhe kjo kompani gjermane, e cila tashmë është e interesuar për ta përkrahur Malishevën.

Rudofl Broher, tha se është i interesuar të përkrahë sektorin e shëndetësisë, ndërsa në të ardhmen, planifikon të zhvilloj një projekt, përmes së cilit, do të sjellë në Malishevë, një delegacion të një grupimi prej 600 bizneseve të Gjermanisë, me qëllim të investimit në fushën e zhvillimit ekonomik dhe social.

Më pas, Begaj dhe Broher, kanë vizituar çerdhen e fëmijëve në Malishevë, QKMF-në, Handikos-in dhe Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi”, ku është njoftuar lidhur me gjendjen në entet shëndetësore dhe arsimore, me qëllim të krijimit të një pasqyre për Malishevën dhe për nevojat që ka Komuna e Malishevës.

Kjo vizitë, është në vazhden e bashkëpunimit të Komunës së Malishevës, me komunat gjermane dhe komunitetin e biznesit në Gjermani.

Kryetari Begaj, priti komandantit e kontingjentit zviceran të KFOR-it, kolonelin Eichenberger

Malishevë, 27 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot, komandantin e kontingjentit zviceran të KFOR-it, kolonelin Eichenberger dhe komandantin e njësisë së monitoruese të saj LMT, në Malishevë, kapitenin Kaufman. Ky takim kishte karakter njoftimi të ndërsjellë, ndërsa u vlerësua lartë bashkëpunimi i mirë mes KFOR-it (LMT-së) dhe Komunës së Malishevës.

“Ne me ushtarët zviceran jetojmë bashkë dhe unë i falënderoj për bashkëpunimin e mirë me komunën, po edhe për kontributin e dhënë, në



përgjithësi të KFOR-it zviceran, por edhe shtetit zviceran. E çmoj lartë bashkëpunimin dhe kontributin e njësisë së LMT-së në Malishevë, si dhe të shtetit zviceran, jo vetëm në rindërtimin e vendit, por edhe për faktin, se Zvicra është një vend ku jetojnë një pjesë e madhe e qytetarëve tanë dhe të cilët janë të inkuadruar në shoqërinë zvicerane”, tha kryetari Begaj.

Ndërsa koloneli Eichenberger, tha se qëllim i këtij takimi, është të njoftohet me të parin e komunës, ku shërbejnë ushtarët zviceran, pasi detyrën e udhëheqjes së kontingjentit zviceran, e ka marrë kohëve të fundit. “Dëshiroj të informohen edhe me situatën në Malishevë, por edhe me sjelljet dhe komunikimin e ushtarëve tanë me qytetarët dhe komunën, gjithashtu, më intereson edhe situata në Malishevë dhe mundësitë e rritjes së bashkëpunimit dhe ndihmës”.

Kryetari Begaj, e ka informuar kolonelin Eichenberger, lidhur me gjendjen e përgjithshme të Malishevës, popullsinë, situatën ekonomike, gjendjen e infrastrukturës së përgjithshme, të arriturat, resurset dhe nevojat që ka Malisheva.

Sa i përket situatës së sigurisë, u vlerësua lartë situata e sigurisë së përgjithshme, ku Malisheva, konsiderohet si njëri prej rajoneve më të qeta në vend.

Shkolla “Visar Krasniqi” bëhet me bibliotekë shkollore

Malishevë, 27 prill



Nxënësit e klasës së pestë, të sh.f.m.u. “Visar Krasniqi” në Drenoc, kanë bërë shkollën e tyre me bibliotekë shkollore, me rreth 500 libra, pasi kjo klasë ka qenë fituese e projektit për bibliotekë, në kuadër të projektit “Kosovizion”. Në ceremoninë e hapjes së kësaj biblioteke, mori pjesë edhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Avdi Morina, znj.Ardita Kabashi, koordinatore e projektit dhe zyrtarë të tjerë.

Hapjen e kësaj biblioteke, e ka ndihmuar edhe Komuna e Malishevës, dhe me këtë rast drejtori komunal i arsimit, Avdi Morina, e quajti pasuri dhe vlerë për shkollën dhe nxënësit. “Qëllim i



yni është investimi në shkolla dhe krijimi i kushteve sa më të mira për nxënësit dhe ju nxënës këtë investim po e tregoni me rezultatet e juaja”, tha drejtori Morina.

Edhe koordinatorja e projektit “Kosovizion”, Ardita Kabashi i ka uruar nxënësit dhe ka treguar për rrugëtimin e nxënësve të kësaj klase, deri në realizimin e projektit të tyre. Më pas drejtori Morina, së bashku me koordinatoren e Kabashi dhe drejtoreshën e shkollës, Bukurije Krasniqi, e kanë bërë hapjen e bibliotekës, e cila aktualisht i ka rreth 500 libra, kryesisht shkollorë, ndërsa përveç komunës, në këtë bibliotekë kanë kontribuar edhe arsimtarët dhe qytetar të tjerë të Drenocit.

Vazhdon dezinfektimi i zonave endemike

Malishevë, 28 prill

Në territorin e Komunës së Malishevës, krahas aktiviteteve tjera, në kuadër të zbatimit të strategjisë për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), është duke vazhduar dezinfektimi i zonave endemike. Kjo fushatë, është duke u bërë sot në fshatrat Marali dhe Gurishtë (ish Goriq), ndërsa fushatën e dezinfektimit, e kanë parë nga afër edhe i pari i Malishevës, Ragip Begaj, me drejtorin e emergjencave Sajdi Paçarizi dhe drejtorin e shëndetësisë, Hajdin Berisha.

Kryetari Begaj, me drejtorët Berisha e Paçarizi, fillimisht janë takuar me përgjegjësit e kompanisë “Truly Nolen”, e cila është duke e kryer dezinfektimin, ku janë njoftuar me ecurinë e kësaj fushate. Sipas përgjegjësve të kompanisë, dezinfektimi po ecën mirë dhe nuk kanë probleme gjatë spërkatjes, si në fushë, ashtu edhe në oborret dhe kopshtet e banorëve.

Më pas, është biseduar me edhe banorët e Gurishtës, ku këta të fundit, i kanë falënderuar të gjithë ata që janë të përfshirë në këtë fushatë të dezinfektimit kundër rriqrave, si bartës së virusit të EHKK. “Ne ndihemi më të sigurt, në veçanti për fëmijët, të cilët gjatë ditës janë ekspozuar në fushë, duke luajtur apo duke i ruajtur bagëtitë”, thanë disa nga banorët e këtij fshati.

“Jemi duke u munduar dhe jemi duke dhënë gjithçka nga ana jonë, në mënyrë që të mos kemi raste të infektimit, apo të vdekjeve nga ethet hemorragjike. Nëse arrijmë që edhe në vitin e tretë radhazi, të mos kemi raste të vdekjeve, është një sukses i jashtëzakonshëm, për të gjithë ne dhe për të gjithë ata që janë angazhuar në për luftimin dhe parandalimin e këtij virusi”, tha me këtë rast kryetari Begaj.

Po ashtu gjatë ditës së sotme, është duke u vazhduar me ligjëratat vetëdijesuese me nxënësit e shkollave të Komunës së Malishevës, për rrezikun nga pickimi i rriqrave dhe masat



parandaluese, për të mos ardhur në kontakt me rriqrat, apo edhe pas pickimit, për mënyrën e trajtimit. Ligjëratat janë duke i mbajtur stafi i QKMF të Malishevës, të përkrahur edhe IKSHP dhe IRSHP në Prizren.

Në të njëjtën kohë, po vazhdon edhe cikli i dytë i repelimit të kafshëve, po ashtu njëra prej masave më efektive për të parandaluar kontaktin me rriqra dhe ndërprerjen e ciklit të rriqrave. Repelimi i kafshëve, sot është duke u kryer në fshatrat Dragobil, Marali dhe Astrazup.

Sa i përket situatës epidemiologjike, sipas drejtorit për shëndetësi, Hajdin Berisha, “pavarësisht rasteve të thumbimeve nga rriqrat, deri më tani, nuk ka raste të infektimit me EHKK”. Berisha, po ashtu tha se “vlen të theksohet, se gjatë vitit të kaluar, falë masave të ndërmarra, ngritjes së vetëdijes dhe kujdesit të shtuar nga vet qytetarët, nuk është regjistruar asnjë rast i infektimit me EHKK, ndërsa në dy vitet e fundit, po ashtu nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes me EHKK, në territorin e Komunës së Malishevës”.

Punëtorët e KEDS-it në Malishevë, ndihmojnë familjen Kryeziu nga Mleqani

Malishevë, 29 prill

Punëtorët e njësisë së KEDS-it në Malishevë, kanë ndihmuar sot familjen e M.Kryeziut nga Mleqani. Sipas përgjegjësit të njësisë së shpërndarjes së energjisë elektrike (KEDS) në Malishevë, z.Dardan Krasniqi, punëtorët e kësaj njësie, janë solidarizuar me këtë familje, duke e ndihmuar familjen me mjete monetare dhe materiale.

Me këtë rast, Krasniqi, i ka falënderuar të gjithë punëtorët e kësaj njësie, për gjestin human në raport me këtë familje. “Me të parë kronikën e televizionit “Klan Kosova”, për gjendjen e familjes Kryeziu, punëtorët e njësisë së KEDS-it, kanë grumbulluar një sasi të mjeteve monetare, si dhe veshmbathje dhe gjëra ushqimore, për ta ndihmuar këtë familje. Për këtë gjest human i falënderoi të gjithë punëtorët”, ka thënë për Zyrën për Informim Publik, z.Dardan Krasniqi.

Këtë ndihmë, sot paradite, punëtorët e njësisë së KEDS-it, të prirë nga z.Krasniqi, do t’ia dërgojnë familjes së M.Kryeziut.

Kryetari i Komunës, prezantoi raportin e punës për vitin e kaluar

Malishevë, 29 prill



Në drejtimin e kryesuesit Aziz Thaçi, sot është mbajtur mbledhja e katërt e rregullt e Kuvendit të Komunës së Malishevës. Në këtë mbledhje, para anëtarëve të kuvendit, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka prezantuar raportin e punës për vitin 2015, të kryetarit dhe qeverisë



komunale. Kuvendi i Komunës së Malishevës, po ashtu sot, ka formuar edhe Këshillin Organizativ për shënimin e 16 Qershorit- Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Pas miratimit të rendit të ditës dhe shqyrtimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar, para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, kryetari Begaj, ka prezantuar punën e tij dhe të qeverisë komunale për periudhën janar-dhjetor 2015. Në këtë raport, kryetari Begaj, ka prezantuar të gjithë angazhimin njëvjeçar, të të gjitha drejtorive dhe sektorëve, ndërsa më pas anëtarët e kuvendit, e kanë shqyrtuar në detaje të gjithë raportin, ku kanë shprehur edhe mendimet e tyre rreth raportit.

Pas miratimit të rendit të ditës dhe shqyrtimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar, para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, kryetari Begaj, ka prezantuar punën e tij dhe të qeverisë

Pas kësaj, KK i Malishevës, ka miratuar kërkesat e tre qytetarëve, për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Po ashtu, KK ka miratuar edhe raportin e komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike të komunës, për qëllim të investimit privat, me interes publik.

Po ashtu KK i Malishevës, ka miratuar edhe planin e punës për vitin 2016, të komisionit të aksionarëve, pastaj ka miratuar edhe kërkesën e Drejtorisë së Urbanizimit, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të Kuvendit të Komunës, për Planin Zhvillimor Komunal, si dhe ka miratuar edhe kërkesën e KDI-së, për iniciimin e procedurave për ndryshimin e Rregullores Komunale për Transparencë dhe formimin e komisionit për këto ndryshime të kësaj rregulloreje.

KK, ka shqyrtuar edhe raportin kumulativ të zyrës së tatimit në pronë për vitin 2015, si dhe ka miratuar bartjen e mjeteve nga të hyrat vetenake nga vitet 2014 dhe 2015, në vitin 2016.

Gjithashtu, sot, me vendim të Kuvendit të Komunës, është formuar edhe Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit-Ditës së Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimit të Komunës së Malishevës.